REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr.2506 Prot. Vlorë, më 29 /09 / 2026

VENDIM

Nr.18 Datë 25/09/2026

"PËR MIRATIMIN E VENDIMIT TË KRYESISË NR. 4, DATË 27.07.2026 "PËR MIRATIMIN E NGRITJES DHE FUNKSIONIMIT TË SISTEMIT TË VIDEO SURVEJIMIT (CCTV) NË AMBIENTET E KËSHILLIT TË QARKUT VLORË DHE NGARKIMIN E KRYETARIT PËR ZBATIMIN E TIJ"

Këshilli i Qarkut Vlorë, i mbledhur në datën 25.09.2026, pasi shqyrtoi vendimin e Kryesisë nr. 4, datë 27.07.2026 dhe relacionin shoqërues, në mbështetje të neneve 81 dhe 82 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; nenit 17 të Rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Qarkut Vlorë", miratuar me Vendimin e KQ nr. 10, datë 19.09.2023, e ndryshuar; Ligjit nr. 19/2016 "Për masat shtesë të sigurisë publike"; Ligjit nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar, veçanërisht nenit 7 të tij; dhe Udhëzimit nr. 03, datë 30.04.2025 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, veçanërisht nenit 2, pika 5 të tij,

VENDOSI:

1. Të miratojë Vendimin e Kryesisë nr. 4, datë 27.07.2026, me përmbajtje si më poshtë:
   a) Miratohet ngritja dhe funksionimi i sistemit të video survejimit (CCTV) në ambientet e institucionit të Këshillit të Qarkut Vlorë, për qëllime të garantimit të sigurisë së personave, mbrojtjes së pronës publike dhe aseteve dhe parandalimit të incidenteve të sigurisë.
   b) Ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut Vlorë të nxjerrë urdhrin zbatues, i cili përcakton llojin, specifikimet dhe vendosjen e kamerave, zonat e sakta nën mbikëqyrje, afatin e ruajtjes, personat e autorizuar me akses dhe masat e sigurisë, në përputhje me Udhëzimin nr. 03/2025.
   c) Ngarkohet Kryetari të miratojë Rregulloren e brendshme për përpunimin e të dhënave personale nga sistemi CCTV.
   d) Ngarkohet Kryetari të sigurojë caktimin e Nëpunësit për Mbrojtjen e të Dhënave dhe regjistrimin e veprimtarisë në regjistrin e veprimtarive të përpunimit të institucionit.

e) Sistemi CCTV nuk duhet të mbikëqyrë hapësirë publike të hapur apo pronë të tretësh përtej perimetrit funksional të institucionit; ndalohet vendosja e kamerave në ambiente ekskluzivisht private.

f) Ngarkohen Kryetari dhe strukturat përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

2. Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

Sekretar i Këshillit të Qarkut
Vllasi Nasaj

Drejtor i Drejtorisë
Anisa Hyseni

Specialist i Shërbimeve
Palush Naçi

Jurist
Alma Myrtaj

KRYETAR

ERVIS MOÇKA

(nënshkruar dhe vulosur)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

RELACION

MBI PROJEKT-VENDIMIN E KRYESISË PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E SISTEMIT TË VIDEO SURVEJIMIT (CCTV) NË AMBIENTET E KËSHILLIT TË QARKUT VLORË

Drejtuar Këshillit të Qarkut Vlorë

Objekti: Paraqitja për shqyrtim dhe miratim e projekt-vendimit për ngritjen e sistemit CCTV dhe përcaktimin e masave për mbrojtjen e të dhënave personale.

I. Qëllimi i relacionit

Ky relacion i paraqitet Kryesisë për të argumentuar nevojën objektive për ngritjen e një sistemi të video survejimit (CCTV) në ambientet e përbashkëta të institucionit të Këshillit të Qarkut Vlorë, si dhe për të garantuar se ky përpunim i të dhënave personale kryhet plotësisht në përputhje me Ligjin nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe Udhëzimin nr. 03, datë 30.04.2025 të Komisionerit. Miratimi i çështjes nga Kryesia, si organ vendimmarrës, përbën aktin bazë të kërkuar shprehimisht nga neni 2, pika 5 i Udhëzimit, mbi të cilin më pas mbështetet urdhri zbatues i Kryetarit.

II. Situata aktuale dhe nevoja objektive

Institucioni administron dokumentacion zyrtar, arkivë, asete dhe vlera publike, dhe pret çdo ditë punonjës, qytetarë dhe palë të treta. Përvoja e viteve të fundit ka nxjerrë në pah dobësi konkrete në sigurinë fizike të ambienteve, të cilat nuk janë hipotetike, por të mbështetura në ngjarje të ndodhura e të dokumentuara:

– **Vjedhja e arkivit / dokumentacionit institucional.** Në vitet e kaluara u konstatua vjedhja me thyerje e dokumenteve arkivore nga ambientet e institucionit, konkretisht zyrate e DAMT. Ngjarja u trajtua me kallëzim penal pranë Policisë së Shtetit.

– **Incidente ndaj sigurisë së personelit nga persona të jashtëm.** Në periudha të ndryshme janë evidentuar raste të kërcënimit / agresionit verbal a fizik / hyrjes së paautorizuar ndaj punonjësve nga persona të jashtëm, të pasqyruara në procesverbale / raportime të brendshme / kallëzime. Mungesa e provave pamore ka dobësuar mbrojtjen e punonjësve dhe ndjekjen e përgjegjësive.

– **Hyrje dhe qëndrim i paautorizuar në zona me akses të kufizuar.** Janë vërejtur raste të hyrjes së personave të paautorizuar në arkivë/zyra shërbimi, pa mundësi kontrolli e gjurmimi të lëvizjeve.

– **Dëmtime të pronës dhe aseteve publike.** Konkretisht në hollin e dëmtime të aseteve dhe pajisjeve që gjenden në holl (tavolinë, karrige, kolltuqe).

Masat ekzistuese (kontrolli fizik në hyrje, bravat, regjistrat e vizitorëve, prania e personelit) janë provuar të pamjaftueshme për të parandaluar këto ngjarje dhe, mbi të gjitha, për të dokumentuar dhe identifikuar autorët. Kjo krijon një boshllëk real sigurie, që rrezikon njëkohësisht personelin, qytetarët, pronën publike dhe vetë integritetin e dokumentacionit të institucionit.

III. Baza ligjore

Ngritja e sistemit CCTV mbështetet në:

a) Ligjin nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", veçanërisht nenin 7 (bazat ligjore të përpunimit);

b) Udhëzimin nr. 03, datë 30.04.2025 të Komisionerit, që rregullon posaçërisht përpunimin nëpërmjet sistemeve të video survejimit.

Udhëzimi njeh shprehimisht si interes të ligjshëm të kontrolluesit pikërisht rrethana si "rreziku nga vjedhja" dhe "kërcënimi për sigurinë fizike ose mendore të personave që qëndrojnë brenda zonës së mbikëqyrur" (neni 2, pika 3). Situata e institucionit tonë përkon drejtpërdrejt me këto rrethana, çka e legjitimon përpunimin pa nevojën e pëlqimit individual, sipas nenit 7 të Ligjit.

IV. Nevoja dhe proporcionaliteti

Ngritja e sistemit i nënshtrohet testit të nevojës dhe proporcionalitetit, i cili plotësohet për arsyet e mëposhtme:

c) Nevoja: qëllimi i sigurisë dhe i mbrojtjes së pronës publike nuk mund të arrihet me mjete më pak ndërhyrëse, të cilat janë provuar të pamjaftueshme përballë ngjarjeve të ndodhura.

d) Përshtatshmëria: video survejimi është mjeti i vetëm që siguron njëkohësisht parandalim (efekt frenues), zbulim dhe dokumentim të provueshëm të incidenteve.

e) Minimizimi: mbikëqyrja kufizohet vetëm te zonat e domosdoshme (hyrjet, korridoret,), duke përjashtuar ambientet ekskluzivisht private dhe hapësirën publike apo pronën e tretësh.

f) Kufizimi kohor: të dhënat ruhen vetëm për afatin e nevojshëm (deri në 72 orë; jo më shumë se 30 ditë për mjediset pa mbikëqyrje të vazhdueshme), me fshirje automatike.

Rrjedhimisht, ndërhyrja në privatësinë e individëve është e kufizuar në minimumin e domosdoshëm dhe qartazi e balancuar me interesin publik të sigurisë.

V. Garancitë për mbrojtjen e të dhënave personale

Për të siguruar përputhshmërinë e plotë me legjislacionin, projekt-vendimi do shoqërohet me këto garanci, të cilat do të konkretizohen në urdhrin zbatues, në rregulloren e brendshme dhe në vlerësimin e ndikimit (VNMD):

g) informim i qartë i subjekteve nëpërmjet tabelës informuese standarde të miratuar nga Komisioneri;

h) akses vetëm për personat e autorizuar, me regjistër aksesi dhe deklarata konfidencialiteti;

i) masa fizike dhe organizative sigurie kundër aksesit, humbjes apo përpunimit të paautorizuar;

j) kryerja e Vlerësimit të Ndikimit në Mbrojtjen e të Dhënave (VNMD) dhe caktimi i Nëpunësit për Mbrojtjen e të Dhënave (DPO), si detyrim i organeve publike;

k) regjistrimi i veprimtarisë në regjistrin e veprimtarive të përpunimit.

VI. Ndikimi financiar dhe administrativ

Zbatimi kërkon koston e vlerësuar të pajisjeve/instalim të përballueshme nga buxheti i institucionit / zëri 602, si dhe ngarkim të kufizuar administrativ për strukturën përgjegjëse. Përfitimi në siguri, në mbrojtje të aseteve publike dhe në parandalim incidentesh e tejkalon ndjeshëm koston.

VII. Propozimi

Bazuar në sa më sipër, i propozoj Këshillit të Qarkut Vlorë të miratojë projekt-vendimin bashkëlidhur, duke ngarkuar Kryetarin për nxjerrjen e urdhrit zbatues, miratimin e rregullores së brendshme dhe caktimin e Nëpunësit për Mbrojtjen e të Dhënave, në përputhje me Ligjin nr. 124/2024 dhe Udhëzimin nr. 03/2025.

Për sa më sipër kërkojmë miratimin nga ana Juaj.